



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	20/11/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ymer DRAGUSHA Drejtor i Prokurimit- Korporata Energjetike e Kosovës
CC:	z. Arben GJUKAJ Drejtor Menaxhues – Korporata Energjetike e Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Furnizim me Goma”

I nderuari z. DRAGUSHA,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Furnizim me Goma” me numër prokurimi: KEKO/14/315/111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: “Furnizim me Goma” me numër prokurimi: KEKO/14/315/111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës - KEK, bazuar në nevojën e sajë për Furnizim me Goma, ka paraparë aktivitetet prokurimi me *Procedurë të Hapur*. Autoriteti Kontraktues ka përgatitë *Njoftimin për Kontratë* me titull: “Furnizim me Goma” me numër prokurimi: KEKO/14/315/111, i cili është publikuar më datë 17/10/2014 në faqen elektronike të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP. Kjo procedurë në vetvete përmban tenderin të ndarë në dy LOTE: Në LOT 1 është paraparë: “Furnizim me goma për automjete, kamion ,traktor, auto vinça”, ndërsa në LOT 2 është paraparë: “Furnizim me goma për makinerinë e rëndë”

Në “Dosjen e Tenderit” faqe 17-20/53, Aneksi 1: SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME (dhe përshkrimi i Lloteve). Në faqen 20/53 të Dosjes së Tenderit, në pikën 1. Autoriteti Kontraktues kërkon si kriter që: “Homologimi duhet të jetë nga një prej pesë vendeve të Bashkimit Europian: Gjermani, Suedi, Francë, Itali ose Austri. Në tabelën e dhënë në fq. 50-53 të dosjes së tenderit prejardhja, homologimi dhe numrat relevant të gomave sipas standardit ECE duhet të plotësohet vendi i homologimit si dhe kolonat tjera”

Autoriteti Kontraktues ka kufizuar origjinën e produktit, me kriterin: “Homologimi duhet të jetë nga një prej pesë vendeve të Bashkimit Europian: Gjermani, Suedi, Francë, Itali ose Austri. Me këtë kriter, Autoriteti Kontraktues favorizon Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminon të tjerë. Autoriteti mund ti referohet një standardi vendor ose ndërkombëtar në përputhje me llojin e furnizimit, por assesi të kufizohet nga vende të caktuara, siç është rasti që me kriterin e lartë cekur. Bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe legale. Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlershme”.

Dogana e Kosovës, bazuar në ligjet në fuqi, gjegjësisht Ligji “Për Kërkesat Teknike Për Produkte Dhe Vlerësim Të Konformitetit, nr Nr. 04/L-039” bënë verifikimin e produkteve para importimit me qëllim të vendosjes në treg. Pra, para se të miratohet hyrja e produktit në qarkullim të lirë, shërbimi doganor apo zyra kompetente doganore është e autorizuar për të kryer verifikimin adekuat të karakteristikave të produktit që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Kosovës. Dogana merr masa kur produkti ka karakteristika që çojnë në dyshimin se produkti përkatës paraqet rrezik serioz për sigurinë, shëndetin, mjedisin dhe natyrën, apo interesa të tjera publike dhe nuk lejon hyrjen e këtyre mallrave. Konsiderojmë se homologimi i Gomave kërkohet nga Doganat e Kosovës në hyrje dhe mbulon kërkesën e Autoritetit Kontraktues në lidhje me domosdoshmërinë e homologimit, pasi që gomat nëse nuk janë të standardeve të larta, paraqesin rrezik për sigurinë e qytetarëve të Kosovës.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; nenin 27 Dosja e Tenderit e Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042;

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për operatorët ose operatorët ekonomik potencial.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!